



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E МАКЕДОНИСË СË

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit), në seancën e 97-të të mbajtur më 27.11.2023, ka miratuar sa vijon.

VENDIM

Denoncimi me numër 12-4822/1 të 09.10.2023, **NDËRPRITET.**

Denoncimi nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-4822 të 2023 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së duhet në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Lënda me numër 12-4822/1 datë 09.10.2023 është ngritur në bazë të denoncimit të paraqitur nga një parashtrues i panjohur, në mënyrë elektronike. Denoncimi përmban pretendime të paqarta, prandaj KSHPK-ja, në mënyrë elektronike, ka kërkuar të dhëna dhe informacione shtesë duke paraqitur kërkesë në adresën elektronike nga e cila është marrë denoncimi.

Duke qenë se kërkesa e paraqitur për plotësimin e aplikacionit nuk është vepruar brenda afatit, d.m.th. nuk është marrë asnjë përgjigje, KSHPK-ja ka konsideruar se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent, për çka ka vendosur që të refuzohet denoncimi dhe të mbyllet dhe arkivohet lënda.

Sipas sa më sipër KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:
- Arkivi i KSHPK-së

përgatiti: м-р Д. Д.
miratoi: С. П. Д.

**KOMISIONI SHETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

